VENDIM
Nr. 17, datë 31.1.2013

MBI SHTYRJEN E ANKANDIT VJETOR TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR VITIN 2013

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "ç" paragrafi "ii" dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 7 germa "b" të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 924, datë 26 dhjetor "Mbi lejimin e shoqërisë KESH sh.a., të importojë energji elektrike për periudhën 1.1.2013 deri 1.3.2013 për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes", Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. OST sh.a. të shtyjë zhvillimin e ankandit vjetor për kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për vitin 2013, në drejtim importi, deri në datën 22.2.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani